



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

### Njoftim për shprehje interesi

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në vijim të miratimit të Udhëzimit Nr. 7780/1, datë 24.05.2018 për disa shtesave e ndryshime në Udhëzimin Nr. 1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar, dhe miratimit të Udhëzimit Nr. 7779/1 datë 24.05.2018 për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin Nr. 1 datë 8.1.2012 “Për dokumentet e qarkullimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre” i ndryshuar, dëshiron të ftojë të gjithë operatorët e interesuar që plotësojnë kriteret bazë të përcaktuar në këto udhëzime, për paraqitje të propozimeve për ofrimin e këtyre shërbime. MIE do të vlerësojë aplikimet bazuar mbi pikat e mëposhtme:

- Akreditimet e disponuar (sistemi baze ISO 17020 dhe fushat mbi të cilat është akredituar)
- Veprimtaria për të cilën akreditohet
  - i. Inspektimet në mjetet motorike
  - ii. Inspektimet në rimorkiot e mjeteve motorike
- Zona për të cilat aplikohet ushtrimi i veprimtarisë
  - i. Zonat ekzistuese ku ushtrohet veprimtaria
  - ii. Zona të reja të propozuara
- Stafit dhe kualifikimet përkatëse
- Sigurimi i zyrave dhe ambienteve ku do kryhet shërbimi
- Sistemi IT dhe format e komunikimit me institucionin
- Mjetet dhe stafi i lëvizshëm, për ofrimin e shërbimit \*Mobile\*
- Deklaratat e përgjegjësisë për kryerjen e shërbimit
- Manualët dhe procedurat e kryerjes së shërbimit
- Sigurimi i informacionit të vërtetë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë mirëpret të interesuarit të paraqesin propozimet e tyre deri me datë 12.08.2018.